

Unité de médecine des violences

Njësia mjekësore e dhunës

Këshillimorja mjeko-ligjore për të rriturit viktima të dhunës

Albanais



Për çfarë është fjala?

Këshillimorja e Njësisë mjekësore të dhunës (UMV) është e hapur për çdo njeri të rritur që është viktimë e dhunës të ushtruar brenda çiftit, në familje apo në bashkësi (në hapësirën publike apo në vendin e punës, për shembull).

Shërbimet e saj sigurohen nga një skuadër infermierësh të formuar në mënyrë të posaçme, që punojnë në bashkëpunim të ngushtë me mjekët ligjorë.

Çfarë ofron ajo?

Këshillimorja u siguron viktimave:

- **një pritje dhe dëgjim të vëmendshëm** duke u dhënë kështu mundësinë që të flasin për ngjarjet e dhunshme me të cilat janë përballur.
- **një vizitë klinike të përqendruar te dhuna e përjetuar, e cila mundëson përpilimin e dokumentacionit mjekësor ligjor** (konstatimin e goditjeve dhe lëndimeve, fotografitë e dëmtimeve). Konstatimi mund ta ndihmojë viktimën në kërkimin e të drejtave të veta.
- **orientimin në gjirin e rrjetit** të institucioneve dhe të shoqatave partnere.

Ky këshillim është **konfidencial dhe falas**.

Ku zhvillohen këshillimet?

Njësia mjekësore e dhunës ka katër qendra këshillimi në kantonin e Vaudit, pikërisht në:

Lausanne, Nyon, Rennaz e Yverdon-les-Bains (shih planin).

Si të merrni takim?

Duke telefonuar vetë në qendrën e këshillimit drejtpërdrejt e me zë, nga e hëna deri të premten nga ora 8 deri në orën 12 e nga ora 14 deri në orën 16, në fundjavë e ditët e pushimit nga ora 8 deri në orën 12.

Lausanne, 021 314 00 60

Nyon, 021 314 08 51

Rennaz, 058 773 64 77

Yverdon-les-Bains, 024 424 42 20

Në rast urgjence:

Policia, 117

Ambulancat, 144

UMV-Lausanne


CHUV

Pritja e Urgjencave

Rue du Bugnon 44


1011 Lausanne

(M2 stacioni CHUV)




UMV-Nyon

Hôpital de Nyon
Pritja e ndërtesës kryesore
Chemin Monastier 10
1260 Nyon
(Autobusat 802 e 803,
stacioni Hôpital)



UMV-Rennaz

Centre hospitalier de Rennaz
HRC Vaud-Valais
Pritja e Hapësirës
shëndetësore Rennaz
Route des Tilles 6A
1847 Rennaz
(Autobusat 111, 120 e 201
stacioni Rennaz-Hôpital)



UMV-Yverdon-les-Bains

Hôpital d'Yverdon-les-Bains
Pritja e ndërtesës kryesore
Rue d'Entremonts 11
1400 Yverdon-les-Bains
(Autobusi 602 stacioni Hôpital)

